

**LIGJI PER NDRYSHIM DHE PLOTËSIM  
TË LIGJIT PËR MATERIALIN ARKIVOR**

**Gazeta zyrtare në R. Maqedonisë nr.72 nga 05.05.2015**

**Neni 1**

Në Ligjin për lëndën arkivore (“Gazeta zyrtare e Republika së Maqedonisë” nr.95/12 dhe 41/14), në nenin 11 në paragrafin 1, pas fjalëve: "Poseduesi i" shtohet fjala “publik”.

**Neni 2**

Në neni 12 fjala “shënim” yavendësohet me fjalën “dokumente”

**Neni 3**

Nenet 13, 14 dhe 15 fshihen.

**Neni 4**

Në nenin 21, paragrafi 1, fjalët: "plani i shenjave arkivore" zëvendësohen me fjalët: "plani i shenjave arkivore me listën e materialit arkivor dhe dokumentar".

Në paragrafin 2 fjalët: “lista e materialit arkivorë, përkatësisht lista e materialit dokumentar me afatet e ruajtjes së tij” zëvendësohen me fjalët: “plani i shenjave arkivore me listën e materialit arkivore dhe dokumentarë”.

Në paragrafin 3 fjalët: “plani i shenjave arkivore, lista e materialit arkivor dhe lista e materialit dokumentarë me afate për ruajtjen e tij” zëvendësohen me fjalët: “plani i shenjave arkivore me listën e materialit arkivor dhe dokumentarë” dhe fjalët. : "plani dhe listat" zëvendësohen me fjalën "e njëjta".

Në paragrafin 4, fjalët: "plani i shenjave arkivore, lista e materialit arkivorë dhe lista e materialit dokumentar me afatet e ruajtjes së tij" zëvendësohen me fjalët: "plani i shenjave arkivore me listën e materialit arkivor dhe dokumentarë", ndërsa fjala "janë" zëvendësohet me fjalën "është".

**Neni 5**

Në nenin 27 paragrafi 1 fjalët: “Materiali arkivor” zëvendësohen me fjalët: “Materiali arkivor konvencional”.

Pas paragrafit 1 shtohet paragrafi 2, i cili thotë:

“Materiali arkivor jokonvencional me proceverbal dorëzohet në Arkiv shtetëror në formën dhe mënyrën e regulluar me aktin nga neni 7 paragrafi 1 i këtij ligji.”  
Në paragrafin 2, i cili bëhet paragraf 3, pas fjalës "publike" shtohen fjalët: "konvencionale dhe jokonvencionale”.

## Neni 6

Neni 28 fshihet

## Neni 7

Në nenin 30 në rreshtin e tretë dhe të katërt pas fjalëve: "personat fizikë" shtohen fjalët: “që kryejnë veprimtari, shërbime ose profesione të lira”.

## Neni 8

Neni 32 ndryshohet si vijon:

“Poseduesit e materialit privat arkivor dhe dokumentar janë të detyruar të mbajnë evidencë për të dhënat bazë ose vetanake për materialin arkivor dhe dokumentar, të miratojë një plan të shenjave arkivore me një listë të materialeve arkivore dhe dokumentare, për të kryer një përzgjedhje aktuale të materialit arkivor dhe dokumentar dhe ta ruajnë me afat të përhershëm materialin arkivor në përputhje me këtë ligj.

Me përjashtim nga paragrafi (1) i këtij neni, poseduesit privat të materialit arkivor të cilët kanë deri në 49 të punësuar janë të obliguar të sjellin planin e shenjave arkivore me listë të materialit arkivor dhe dokumentarë, nëse kanë material arkivore dhe ta ruajnë në afat të përhershëm materialin arkivor.

Në rast të ndërprerjes së poseduesit privat të materialit arkivor, materialin arkivor nga paragrafët 1 dhe 2 të këtij neni, është i detyruar t'ia dorëzojë atë pasardhësit ligjor, gjegjësisht t'ia dorëzojë Arkivit të shtetëror nëse nuk ka pasardhës ligjor, në afat brenda 15 ditëve nga ndërprerja.

## Neni 9

Në nenin 36 në paragrafin 17 në fund të fjalisë pas presjes shtohen fjalët: "për të cilën ai paguan kompensim nga posedusei,".

Në paragrafin 18, në fund të fjalisë, pas presjes, shtohen fjalët: "për të cilën ai paguan kompensim nga posedusei,".

Pas paragrafit 18, shtohet paragraf i ri 19, i cili thotë:

“- përzgjedh, rregullon, përpunon dhe përgatit përshkrim të inventarit analitik ose përmbledhës të materialit arkivor publik dhe privat, veçon materialin dokumentar për asgjësimin dhe kryen shërbime të tjera që lidhen me materialin arkivor dhe dokumentar, të poseduesit publik dhe privat të materialit arkivor dhe dokumentari, për të cilin paguhet kompensim nga poseduesit”.

Pas paragrafit 1, shtohen dy paragrafë të rinj 2 dhe 3, në të cilët thuhet:

“Shuma e kompensimeve nga paragrafi 1, pika 17, 18 dhe 19 të këtij neni sipas Çmimores përcaktohet nga drejtori i Arkivit shtetëror në bazë shpenzimeve reale të bëra në varësi të

vëllimit të punës, numrit të punonjësve të angazhuar dhe kohën e nevojshme për realizimin e detzrave për të cilat paguhet kompensimi.

Për Çmimoren nga paragrafi 2 i këtij neni e miraton Qeveria e Republikës së Maqedonia”.

### **Neni 10**

Në nenin 41, paragrafi 1, fjalët: “lënda arkivore” zëvendësohen me fjalët: "material arkivor".

Në paragrafin 3, pika në fund të fjalisë zëvendësohet me presje dhe shtohen fjalët: "me kopjim ose digjitalizim të detyrueshëm para dorëzimit, në shpenzim të subjektit për nevojat e të cilit paraqet materiali arkivor nga Arkivi e shtetëror”.

### **Neni 11**

Në nenin 47 paragrafi 1 në fjalinë hyrëse pas fjalës “e kufizuar” shtohen fjalët: “me vendim të drejtorit të Arkivit shtetëror”.

Pas paragrafit 1, shtohet një paragraf i ri 2, i cili thotë:

“Kundër vendimit nga paragrafi 1 i këtij neni mund të parashtrohet ankesë deri te Komisioni shtetëror për vendimmarrje në procedurat administrative dhe të procedurës për marrëdhënie pune në shkallën e dytë”.

### **Neni 12**

Pas nenit 47 shtohet neni i ri 47-a, i cili thotë:

#### **“Neni 47-a**

Për miratimin e përdorimit të materialit arkivor dhe dokumentar në Arkivin shtetëror, si dhe në rast refuzimi të kërkesës për shfrytëzim, drejtori sjell vendim kundër të cilit mund të parashtrohet ankesë deri te Komisioni shtetëror për vendimmarrje në procedurat administrative dhe të procedurës për marrëdhënie pune në shkallën e dytë”.

### **Neni 13**

Në nenin 57, paragrafi 3 ndryshohet dhe thuhet:

“Inspektor mund të jetë personi i cili i plotëson kushtet e përcaktuara me Ligjin për mbikëqyrjen inspektuese”.

### **Neni 14**

Në nenin 61, paragrafi 2 ndryshohet dhe thuhet:

“Pas ankimimit të vendimit të inspektorit vendos Komisioni shtetëror për vendimmarrje i shkallës së dytë në fushën e mbikëqyrjes inspektuese dhe procedurës për kundërvajtjes.”

## Neni 15

Neni 62 ndryshohet dhe thuhet:

“Drejtori i Arkivit të shtetëror (në tekstin e mëtejme: drejtori) përgatit propozimin e Programit vjetor për punën e shërbimit inspektues dhe i njëjti dorëzohet deri në Këshillin inspektues, jo më vonë se 30 shtator të vitit rrjedhës për vitin e ardhshëm.

Drejtori miraton Programin vjetor për punën e shërbimit inspektues me afat brenda shtatë ditëve nga dita e marrjes së mendimit nga Këshilli inspektues, pra jo më vonë se 10 dhjetori i vitit rrjedhës, nëse Këshilli inspektues nuk e ka shqyrtuar dhe nuk ka paraqitur mendim, pra vërejtje brenda afatit të për caktuar nga ky ligj.

Bazuar në Programin vjetor për punën shërbimit inspektues, drejtori përgatit planet tremujore për punë për çdo inspektor, i cili ia paraqet ato në formë përmbledhëse për shqyrtim deri te Këshilli për inspektimit jo më vonë se dy javë përpara fillimit të tremujorit të ardhshëm kalendarik, deri më 15 dhjetor për tremujorin e parë të vitit pasardhës, deri më 15 mars, për tremujorin e dytë, deri më 15 qershor për tremujorin e tretë, pra deri më 15 shtator për tremujorin e katërt të vitit rrjedhës.

Në planet tremujore për punë për çdo inspektor drejtori detyrimisht parasheh numrin e inspektimeve të planifikuara në tre muajt e ardhshëm, si dhe shkalla e kompleksitetit të secilit prej mbikëqyrjeve.

Bazuar në planet tremujore për punë për çdo inspektor drejtori përgatit një plan mujor për punë, i cili përmban edhe një plan inspektimesh sipas datës dhe sipas subjekteve të mbikëqyrjes.

Drejtori jo më vonë se dy javë nga fillimi i tremujorit rrjedhës kalendarik për të mëparshmen, ai i paraqet Këshillit të inspektimit raporte përmbledhëse tremujore punën e çdo inspektori dhe atë deri më 15 janar për tremujorin e katërt të një vit më parë, deri më 15 prill për tremujorin e parë, deri më 15 korrik për të dytin tremujori, pra deri më 15 tetor për tremujorin e tretë të vitit rrjedhës.

Drejtori jo më vonë se 1 marsi i vitit rrjedhës në Këshillin e inspektimit paraqet Raport vjetor për punën e shërbimit inspektues për vitin e kaluar.

## Neni 16

Në nenin 64 paragrafi 1 në fjalinë hyrëse fjalët: “dhe kundër personit juridik dhe personit përgjegjës pranë poseduesit privat të materialit arkivor dhe dokumentar” fshihen.

Në paragrafin 20 fjalët: “plani i shenjave arkivore, lista e materialit arkivor dhe listae materialit dokumentar me afate për ruajtjen e tij dhe jo i” zëvendësohen me fjalët: "plani i shenjave arkivore me listën materialit arkivor dhe dokumentar dhe jo atë”

## Neni 17

Neni 65 ndryshohet dhe thuhet:

“Dënohet me gjobë në shumë prej 1.000 deri në 2.000 euro në denarë i shqiptohet për shkelje të personit juridik që ka mbi 49 punonjës dhe që është posedues privat i materialit arkivor dhe dokumentar, nëse nuk mban evidencë bazë ose të dhënat e veta për materialin arkivor dhe dokumentarë, nuk kanë sjellë plan për shenjat arkivore me listë të materialit arkivore dhe dokumentare, nuk kryen përzgjedhjen e vazhdueshme nga materiali arkivor dhe dokumentar dhe

nuk e ruan materialin arkivor në kohë të përhershme (neni 32 paragrafi 1).Do ti shqiptohet gjobë në shumë prej 500 deri në 1000 euro në denarë personi përgjegjës të personin juridik për kundërvajtje nga paragrafi 1 i këtij neni”.

### **Neni 18**

Pas nenit 65, shtohet neni i ri 65-a, i cili thotë:

#### **“Neni 65-a**

Gjobë në shumë prej 500 deri në 1.000 euro në denarë i shqiptohet personit juridik që ka deri në 49 punonjës dhe është posedues privat i material arkivor nëse nuk sjell plan për shenja arkivore me listë për material arkivor dhe dokumentar, nëse ka material arkivor ose nuk e ruan përgjithmonë materialin arkivor (neni 32 paragrafi 2).

Gjobë në shumë prej 250 deri në 500 euro në denarë do ti shqiptohet personit përgjegjës pranë personit juridik që ka deri në 49 punonjës për kundërvajtjen nga paragrafi 1 i këtij neni”.

### **Neni 19**

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e tetë nga dita e botimit në “Gazetën zyrtare të Republikës së Maqedonisë”.